



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika-Odeljene za
Politike Pravosudnog Sistema, Slobodne Profesije I Statistiku- Department of Justice Sytem
Policies, Freelance Professions and Statistics

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPSDPLS.nr.3/2025

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr. 656/21, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija Kërveshi, palës ankuese me seli në përfaqësuar nga nga Prishtina, Përmbaruesit privat, me datë 12.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë- Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika , DPSDPLS. 3/2025 i datës 28.02.2025, si dhe ankesa e palës ankuese me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga nga Prishtina, e datës 27.02.2025 si të pabazuara.

II. Përmbaruesi Privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore, P.nr.656/21.

A r s y e t i m

Pala ankuese, me seli në ne datën 27.02.2025 ka parashtruar ankesë ndaj përmbauesit privat, pasi sipas ankesës, përmbauesi privat me veprimet e tij ka bërë shkelje sepse përkundër që ekzistojnë bazat ligjore për përmbaerim të rastit, i njejt i nuk ka ndërmarre veprime për përmbaerim të obligimit të debitorit

Në seancën e mbajtur, pala ankuese deklaroi se në shkresat e lëndës ekzistojnë prova të mjaftueshme që ekzekutimi në këtë lëndë të kryhej, bazuar edhe në vendim të Gjykatës Komerciale të dhomës së shkallës së dytë me nr.1286/24 të datës 01.11.2024 dhe të përmirësuar me dt.20.11.2024 është dashur që përbrenda afateve ligjore ta ekzekutojë siç parashihet edhe me Ligjin e procedurën përmbaerimore LPP-së.

Lëndë të natyrës së njejtë përmbauesit tjerë i kanë kryer, por ky përmbaues nuk e ka ekzekutuar këtë rast, edhe pse nuk ka pasur bazë ligjore për mosvazhdimin e përmbaerimit.

Përmbauesi privat ka deklaruar në përgjigjen e tij se lënda ka qenë me prapësim dhe derisa është vendosur lidhur me prapësimin nuk ka vepruar, se me kërkesë të palëve është vepruar, por meqë disponon me lëndë të natyrës së tillë në punë relativisht shumë dhe duke dashur që të respektoi prioritetet sipas radhës, nuk është vepruar më heret dhe faktin që debitori nuk është sqaruar se është në menagjim të AKP-së.

Në seancë përmbauesi ka mbetur pranë përgjigjes në ankesë dhe është deklaruar se si organ përmbaues ka vepruar dhe vazhdon të veproj komform dispozitave të LPP-së.

Deri në fillim të muajit dhjetor 2024 pasi është kthyer lënda ka ndërmarre veprime përmbaerimore si bllokimi i llogarive dhe dalja në terren .Në muajin janar ka ardhë kërkesa e kreditorit për përjashtimin e përmbauesit dhe atij i është dashur të pres vendimin e gjykatës. Sipas vendimit të gjykatës, përmbauesi nuk është përjashtuar nga rasti si përmbaues.

Rasti nuk është përmbaeruar për arsye se lënda ka qenë në gjykatë dhe dikur për shkak se ky rast për përmbauesin është më kompleks sepse mendohet se debitori është nën menagjim të AKP-së, prandaj i duhet kohë për sqarim të rastit si dhe ka disa raste e që do trajtohet me radhë.

Përmbauesi ka kërkuar që ankesa e ushtruar ndaj tij të refuzohet si e pa bazuar, pasi nuk ka prova dhe fakte që mbështesin pretendimet e palës ankuese.

Komisioni ka shqyrtuar pretendimet ankimore, por nuk ka gjetur ndonjë provë me të cilën do provohej që përmbauesi privat ka bërë tejkalim të autorizimeve apo ndonjë shkelje sipas pretendimeve në ankesë dhe nuk ka mundur të vërtetohet me provat e ofruara ndonjë shkelje ligjore. Komisioni ka analizuar provat e ofruara, dhe ka pasur parasysh edhe deklarin e palës ankuese, por dhe veprimet e përmbauesit, pasi përmbauesi ka ndërmarre veprime dhe lëndën e ka në procesim si dhe hezitimet për mos vendosje ende për shkak të specifikave të rastit.

Ligjërisht nuk është i precizuar asnjë afat për finalizim të rastit në aspektin kohor dhe përmbauesi ka ndërmarre disa veprime si dhe ka deklaruar që do e trajtoj këtë rast sipas radhës dhe me prioritet

për shkak të statusit të debitorit, gjë që për komisionin nuk ka ndonjë bazë që mos finalizimi dhe mos ndërmarrja e veprimeve përmbartimore si dhe vonesat në aspektin kohor sipas palës ankuese mund të paraqesin shkelje të dispozitave të caktuara ligjore.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPSDPLS.nr.3/2025 datë 12.06.2025



Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaçi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.